



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SKRAPAR

VENDIM
Nr. 66, datë 24. 10. 2022

“PËR NJË NDRYSHIM NË VKB NR. 65, DATË 24.12.2021 “PËR MIRATIMIN E PBA 2022-2024 DHE BUXHETIT VJETOR 2022, TË BASHKISË SKRAPAR DHE INSTITUCIONEVE NË VARËSI TË SAJ” LIDHUR AKORDIMIN E FONDEVE BUXHETORE PER PROJEKTIN “SKRAPARI NE KENGE”

Këshilli Bashkiak Skrapar në mbledhjen e datës 24. 10. 2022, mori në shqyrtim projektaktin e hartuar nga grupi i Menaxhimit Strategjik, i ngritur me Urdherin Nr.86, datë 11. 03. 2022 në mbështetje të Ligjit Nr. 9936, datë 26. 06. 2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, neni 6; 15; 17; 22; 23; 24; 25; 26; 32, i ndryshuar me Ligjin Nr. 57/2016, “Për disa ndryshime në Ligjin Nr. 9936, datë 26. 06. 2008”, të Ligjit Nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr.68/2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, neni 6; 7; 39; 40; 41, Ligjit 115/2021, datë 25. 11. 2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, si dhe në Udhëzimin e Ministrisë së Financave Nr.09, datë 20. 03. 2018, “Për Procedurat Standarte të Zbatimit të Buxhetit”

VENDOSI:

1. Të akordohen fonde buxhetore në vlerën prej 400,000 lekë për realizimin e Projektit “Skrapari në Këngë”.
2. Fondet të akordohen nga të ardhurat e planifikuara të vitit 2022, në zërin buxhetor “Shpenzime Operative” artikulli 602.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet: Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Tatim Taksave.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikes 6, të nenit 55, të Ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Vendimi u miratua me 10 vota pro , vota kundër - 1 , vota abstenim – s’ka .

Për konfirmim Prefektit të Qarkut Berat .



KRYETARE KËSHILLIT BASHKIAK
Edlira SHKËMBI

